

GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE

shpall konkursin për kurator të Ekspozitës Ndërkombëtare

"Onufri XXII"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE

Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, shpall Konkursin Ndërkombëtar për Kurator për realizimin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore "ONUFRI XXII" që do të zhvillohet gjatë muajve Dhjetor 2016 – Shkurt 2017 në GKA.

Kushtet e pjesëmarrjes janë:

- Në konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë kuratorë me nënshtetësi shqiptare dhe të huaj.
- Kuratori/kuratorja duhet të ketë të dokumentuar kurimin e të paktën 2 (dy) ekspozitave ndërkombëtare dhe 3 (tre) kombëtare.
- Të ketë minimumi 7 vjet eksperiencë pune.
- Të ketë botuar artikuj/ese/shkrime mbi artin në revista/katalogë/albume të publikuara në këto 5 vitet e fundit.

Mënyra e aplikimit

Të interesuarit duhet të paraqesin në GKA një dosje/aplikim me dokumentacionin e mëposhtëm, deri më datë 3 maj 2016.

- Një kërkesë për të marrë pjesë në këtë konkurim për kurator;
- Konceptin kuratorial dhe një përshkrim se si mendon kuratori/kuratorja të zhvillojë ekspozitën;
- CV artistike/akademike (bashkë me të dhënat personale se ku mund të kontaktojmë);
- Botime, katalogë, revista të ndryshme ku të jenë të botuara shkrimet e tij/saj.

Të tjera

Shpallja e kuratorit/kuratores fituese bëhet nga Këshilli Organizativ i Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “ONUFRI XXII” brenda muajit maj 2016, pas shqyrtimit të aplikimeve të ardhura brenda afatve të përcaktuara në këtë shpallje.

Këshilli Organizativ i Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “ONUFRI XXII” përbëhet nga minimumi 5 anëtarë: 2 punonjës të GKA dhe 3 specialistë të jashtëm.

Kuratori nuk duhet të jetë punonjës i GKA dhe nuk mund të jetë në të ardhmen anëtar i Jurisë së Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “ONUFRI XXII”.

Kuratori zgjedh vetë as/kuratorin i cili mund të jetë me kombësi/nënshtetësi shqiptare apo të huaj. Të drejtat dhe detyrat e të dyve janë të përcaktuara në Rregulloren e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “ONUFRI”.

Kuratori/kuratorja fitues/e hyn në marrëdhënie kontraktuale të përkohëshme pune me Kontratë me GKA, sipas dispozitave në fuqi të Kodit Civil dhe Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Fondi bazë për realizimin e Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore “ONUFRI XXII” është 1,000,000 (një milion) lekë.

Për çdo lloj pyetjeje dhe sqarimi tjetër mbi kushtet e pjesëmarrjes, lutemi të na shkruani në: info@galeriakombetare.gov.al ose telefononi në +355 42 233 975.